

## **STATUT I SHOQATËS “SHOQATA SHQIPTARE E SHKENCAVE POLITIKE”**

### **NENI 1 - EMËRTIMI DHE SELIA**

Emërtimi i Shoqatës është: “Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike,” shkurt “ShShShP” (më poshtë referuar si “Shoqata”).

Selia e Shoqatës është në Tiranë, Rruga “Gavril Dara” Nr. 4, Shqipëri. Shoqata do të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me vendim të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Anëtarëve edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke krijuar edhe degë në qytete ose vende të tjera ku ndodhen institucione shqiptare ose gjuha e komunikimit e të cilave është shqipja.

### **NENI 2 - VULA**

Organizata ka një vulë e cila do të jetë në formë të rrumbullakët. Në gjysëmharkun e sipërm shkruan “Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike,” kurse në gjysëmharkun e poshtëm shkruan “Albanian Political Science Association.” Në qendër të vulës është harta e Shqipërisë.

Vula do të jetë nën ruajtjen e Sekretar-Financierit, i cili e vendos atë në të gjitha dokumentat që duhet të vulosen.

Një riprodhim i vulës zyrtare mund t’i besohet secilit anëtar të autorizuar nga Bordi Drejtues për të vepruar si agjent për Shoqatën në çdo çështje në të cilën kërkohet që një dokument të jetë i vulosur.

### **NENI 3 – OBJEKTIVAT**

Kjo Shoqatë krijohet si një organizatë jo fitimprurëse. Ajo do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në mënyrë të veçantë me Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë,” këtë Statut dhe Aktin e Themelimit të saj.

Shoqata është një shoqatë kulturore, edukative dhe shkencore, qëllimet e së cilës janë:

- a. të inkurajojë dhe zhvillojë shkencën politike dhe marrdhëniet e saj me disiplina të tjera akademike;
- b. të inkurajojë dhe zhvillojë shkencën politike dhe marrdhëniet e saj me disiplina të tjera;
- c. të organizojë konferenca dhe mbledhje për të diskutuar probleme të shkencave politike dhe për të shkëmbyer pikëpamje për çështje që kanë të bëjnë me shkencat politike;
- ç. të shesë, blejë, marrë si dhurime, çdo trashëgimni, pronë apo dhurim për objektivat e Shoqatës;
- d. të japë grante, bursa studimi apo ndihma financiare individëve të cilët e meritojnë, grupeve të personave apo organizatave në përputhje me objektivat e Shoqatës;
- dh. të botojë gazeta, revista, libra dhe monografë që kanë të bëjnë me shkencat politike;
- e. të lehtësojë aplikimin e anëtarëve të saj për grante për projekte që kanë të bëjnë me shkencat politike;

- f. dhe në përgjithësi të organizojë të gjitha aktivitetet me qëllim jo fitimprurës për të realizuar objektivat e saj.

Shoqata si e tillë nuk do të marrë përsipër vetë apo nënpërmjet anëtarëve të saj të përmbushë çfarëdo kërkesë të politikës publike, e cila nuk lidhet direkt me disiplinën e shkencave politike në të cilën ushtron aktivitet për të përmbushur qëllimet e saj duke u bazuar në:

- a. Parimin e pjesëmarrjes së lirë, anëtarësisë së vullnetshme dhe të lirë për të gjithë qytetarët shqiptarë ose të huaj që plotësojnë kërkesat e këtij Statuti;
- b. Parimin e bashkëpunimit me organizata, shoqata ose individë të ndryshëm vendas ose të huaj.

#### **NENI 4 – KOHËZGJATJA**

Kjo Shoqatë krijohet për një periudhë të pacaktuar kohore.

#### **NENI 5 - ANËTARËSIA**

Anëtarësia në Shoqatë është e hapur për të gjithë ata të cilët pranojnë objektivat e përcaktuara në këtë Statut.

Anëtarësia mund të përfshijë si individë ashtu edhe institucione. Në rastin e individëve, një person mund të bëhet anëtar i Shoqatës nëse ajo/ai ka një diplomë shqiptare ose të një institucioni në vende të tjera, në shkencat politike ose nëndisiplinat e saj.

Anëtarët do të gëzojnë të gjitha të drejtat e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar mbi shoqatat. Gjithashtu, ata kanë këto të drejta dhe detyrime:

- a. të paguajnë kontributet siç parashikohet prej këtij Statuti;
- b. të ndjekin rregullat e parashikuara nga ky Statut;
- c. të përfitojnë nga aktivitetet e kryera nga Shoqata.

Anëtarët humbasin të drejtën e tyre të anëtarësisë në Shoqatë në rastet e mëposhtme:

- a. paraqitje e dorëheqjes vullnetare të paktën 2 (dy) muaj para përfundimit të vitit kalendarik;
- b. shkelje e rregullave të parashikuara nga ky Statut;
- c. shpërndarje e Shoqatës;
- ç. përjashtimi me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve.

#### **NENI 7 – ORGANET DREJTUESE TË SHOQATËS**

Organet drejtuese të Shoqatës janë:

- a. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- b. Bordi Drejtues;
- c. Kryetari;
- ç. Zëvendës Kryetari;
- d. Sekretar-Financieri.

Çdo anëtar i Shoqatës, i cili merr përsipër detyrime në emër dhe për llogari të Shoqatës

## **NENI 8 – MBLEDHJET E PËRGJITHSHME TË ANËTARËVE**

Të gjithë anëtarët e Shoqatës kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarëve. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve mund të mbledhet në Mbledhje të Zakonshme ose në Mbledhje të Jashtëzakonshme. Çdo anëtar ka të drejtën e një vote në Mbledhjen e Përgjithshme. Shoqata do të organizojë të paktën një Mbledhje të Përgjithshme të Zakonshme në çdo vit kalendarik.

Njoftimi për Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore, kohën, vendin dhe përmbajtjen, do t'u dërgohet me postë të gjithë anëtarëve në adresat e tyre të përcaktuara në librin e anëtarëve të Shoqatës të paktën 45 (dyzetepesë) ditë para ditës së Mbledhjes së Përgjithshme të Zakonshme.

Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve vendos mbi:

- a. zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues, Kryetarin, ZëvendësKryetarin dhe drejtuesit e tjerë të Shoqatës;
- b. heqjen nga detyra të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe drejtuesve të tjerë të Shoqatës. Gjithashtu miraton propozimin e Bordit Drejtues për heqjen nga detyra të anëtarëve të Bordit Drejtues;
- c. pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve të Shoqatës;
- ç. miratimin e deklaratave financiare, shpërndarjes së fondeve dhe për orientimet e përgjithshme të politikave të Shoqatës;
- d. kuotat e abonimit në çfarëdo botimi të Shoqatës;
- dh. hapjen e degëve brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- e. shumën e kontributeve për t'u paguar sipas Nenit 12 të këtij Statuti;
- ë. ndryshimin e Statutit të Shoqatës;
- f. ndërrimin e emrit të shoqatës;
- g. ndryshimin e formës së Shoqatës në një formë tjetër juridike, ose bashkimin apo shpërndarjen e saj;
- gj. zgjedh një kontrollues finance;
- h. çdo çështje tjetër që nuk është lënë në kompetencën e ndonjë organi tjetër të Shoqatës.

Prania e jo më pak se 50% (pesëdhjetë përqind) e të gjithë anëtarëve do të përbëjë quorum-in për Mbledhjet e Përgjithshme të Zakonshme dhe shumica e thjeshtë e të pranishmëve do të jetë e nevojshme për të marrë votime. Për ndryshimin e Statutit, përjashtimin e një anëtari, apo dhe shpërndarjen e Shoqatës duhet të jenë të pranishëm të paktën 3/4 e anëtarëve. Për heqjen nga detyra të anëtarëve të Bordit Drejtues, edhe në rastin kur kjo është propozuar nga vetë Bordi Drejtues, apo organeve të tjera drejtuese të Shoqatës, nevojitet vota e 2/3 së anëtarëve të Shoqatës të pranishëm.

Kryetari i Shoqatës ose Bordi Drejtues mund të thërrasë Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Anëtarëve të Shoqatës kur ai e gjykon të nevojshme një gjë të tillë për interesin më të mirë të Shoqatës. Procedura e njoftimit për të tilla mbledhje do të jetë e njëjtë me atë të Mbledhjes së Zakonshme me përjashtim të afatit të njoftimit, i cili do të jetë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar. Lajmërimi duhet të përmbajë arsyet e mbledhjes, çështjet që do të trajtohen në këtë mbledhje dhe cili ka kërkuar organizimin e mbledhjes. Kryetari duhet të thërrasë Mbledhjen e Jashtëzakonshme me kërkesën e anëtarëve të Bordit Drejtues, ose 1/5 së anëtarëve të

Procesverbali i çdo Mbledhje të Përgjithshme do të shkruhet prej Sekretar-Financierit dhe do të nënshkruhet prej tij, ose prej çdo personi tjetër i caktuar me vendim të Bordit Drejtues, dhe Kryetarit.

## **NENI 9 – BORDI DREJTUES**

Bordi Drejtues do të jetë i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a. Kryetari, Zëvendës Kryetari dhe Sekretar-Financieri, të cilët janë të përhershëm;
- b. 6 (gjashtë) anëtarë të tjerë të cilët zgjidhen për një afat prej dy vitesh, gjysma e të cilëve rinovohet çdo vit.

Bordi Drejtues vepron vetëm në emër të Shoqatës. Ai do të ketë kompetencat e mëposhtme:

- a. kontrollon dhe drejton aktivitetin e Shoqatës;
- b. mund të punësojë ose pushojë nga puna personel në përputhje me nevojat e Shoqatës;
- c. do të jetë i përgjegjshëm për programet e publikimeve dhe konferencave të shoqatës;
- ç. mund të bëjë shpërndarjen e parave sipas programeve;
- d. propozon kontributin e pagesës për anëtarët e shoqatës dhe kuotën e abonimit në botimet e shoqatës;
- dh. përcakton pagesën për kontrolluesin e financave;
- e. gjithashtu mund të krijojë komitete të caktuara duke i caktuar edhe detyrat përkatëse;
- ë. zgjedh Kryetarin, Zëvendës Kryetarin, Sekretar-Financierin në mbledhjen e tij të parë pas Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore të Anëtarëve;
- f. i propozon Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve heqjen nga detyra të anëtarëve të Bordit Drejtues me votën e 2/3 së anëtarëve të Bordit Drejtues;
- g. plotëson vendet bosh në Bordin Drejtues dhe drejtuesit e Shoqatës të shkaktuar nga vdekja, dorëheqja, pushimi nga detyra ose dështimi në zgjedhje, duke caktuar këta persona të qëndrojnë në detyrën e zgjedhur deri në zgjedhjet e ardhshme.

Bordi Drejtues do të mbledhet të paktën një herë në çdo vit kalendarik. Bordi Drejtues mund të mbledhet edhe me kërkesë të Kryetarit ose në bazë të kërkesës me shkrim të 3 anëtarëve të Bordit Drejtues. 5 (pesë) anëtarë të Bordit Drejtues përbëjnë quorum-in dhe shumica e votave të të pranishmëve do të jetë e nevojshme për marrjen e vendimeve.

Njoftimi për mbledhjen e Bordit Drejtues do të jepet të paktën 3 ditë përpara ditës së caktuar për mbledhje, vetëm në rastin kur anëtarët e Bordit Drejtues do të jenë të gjithë të pranishëm.

Çdo anëtar ka të drejtën e një vote dhe këtë të drejtë nuk mund ta delegojë me anë të prokurës.

Bordi Drejtues mund të hartojë rregulla dhe rregullore për organizimin e mbledhjeve të tij në mënyrën që ai me diskrecionin e tij do ta gjykojë të arsyeshme.

Kryetari i Shoqatës për shkak të funksionit të tij është edhe Kryetar i Bordit Drejtues.

## **NENI 10 - DREJTUESIT**

**Kryetari** drejton të gjitha mbledhjet e Shoqatës dhe të Bordit Drejtues. Në mbledhjen e parë të Zakonshme të Anëtarëve të Shoqatës, ai do të paraqesë një raport vjetor për punën e Shoqatës. Ai do të ketë ato kompetenca që janë të nevojshme për një përfaqësues ligjor të Shoqatës. Ai duhet të vërë në jetë vendimet e Bordit Drejtues, me përjashtim të rastit kur është vendosur ndryshe. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqatën përpara palëve të treta. Ai autorizon shpërndarjen e të gjitha mjeteve financiare të Shoqatës, sipas vendimeve të marra nga organet kompetente. Kryetari zgjidhet për një afat kohor një vjeçar nga Bordi Drejtues në mbledhjen e tij të parë pas Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore të Anëtarëve.

**Zëvendës Kryetari**, ndihmon Kryetarin në të gjitha detyrat e tij zyrtare ne mungesë ose pamundësi të Kryetarit, do të ushtrojë funksionet e tij dhe vepron si Kryetari i Shoqatës me të drejtat, privilegjet, dhe kompetencat që do të kishte pasur po të kishte qenë zgjedhur Kryetar. Ai do të emërohet nga Mbledhja e Zakonshme e Përgjithshme e Anëtarëve.

**Sekretar-Financieri** do të mbajë procesverbalet dhe të dhënat e Shoqatës në librat përkatës. Ai jep dhe dërgon të gjitha njoftimet për anëtarët e Shoqatës. Ai është ruajtësi zyrtar i vulës së Shoqatës. Ai mund të jetë një nga drejtuesit që kanë të drejtë të nënshkruajnë çeqe dhe urdhër pagesa në emër të Shoqatës. Ai do t'i paraqesë Bordit Drejtues çdo njoftim apo komunikim që i është drejtuar atij si Sekretar i Shoqatës. Ai do të mbajë të gjithë korrespondencën e Shoqatës dhe do të ushtrojë të gjitha detyrat që lidhen me funksionin e Sekretarit. Ai kujdeset dhe ka në kujdestari të gjitha paratë dhe pasuritë që i përkasin Shoqatës. Financieri përgatit në periudhat e parashikuara, të vendosura nga Bordi Drejtues, një deklaratë me shkrim të financës së Shoqatës dhe një raport i tillë i bashkëngjitet fizikisht procesverbalit të kësaj mbledhjeje të Bordit Drejtues. Ai do të ushtrojë të gjitha detyrat e lidhura me funksionin e Financierit.

**Kontrolluesi i financës** zgjidhet një herë në vit në mbledhjen e parë vjetore të Të Përgjithshme të Anëtarëve. Ai do të kontrollojë pasqyrat financiare vjetore të Sekretar-Financierit. Ai shqyrton dhe raporton mbi çfarëdo çështje tjetër financiare të Shoqatës sa herë që kjo kërkohet nga Bordi Drejtues.

Zyrtarët mund edhe të mos jenë anëtarë të Shoqatës.

## **NENI 11 - KOMITETET**

Bordi Drejtues cakton të gjitha komitetet e Shoqatës, detyrat dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së tyre.

## **NENI 12 - FONDET**

Fondet e Shoqatës përbëhen prej:

- a. Kuotave dhe kontributeve të të gjithë anëtarëve;
- b. Financimeve dhe donacioneve të bëra prej individëve dhe/ose personave juridikë.

## **NENI 13 - NDRYSHIMET**

#### **NENI 14 - SHPËRNDARJA**

Nëse Shoqata shpërndahet nga Mbledhja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Anëtarëve, me praninë e të paktën 3/4 të anëtarëve. Kjo mbledhje emëron një komision likuidimi. Komisioni i likuidimit likujdon Shoqatën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nëse Shoqata është shpërndarë me vendim të gjykatës kompetente, kjo e fundit emëron një komision likuidimi.

Në rastin e shpërndarjes të gjitha pasuritë e shoqatës, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve, do t'i shpërndahen një apo më shumë organizatave bamirësë në Shqipëri ose Kosovë.

#### **NENI 15 – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Statuti, e lindur gjatë kohëzgjatjes së kësaj Shoqate, fillimisht tentohet të zgjidhet me mirëkuptim. Nëse çështja nuk zgjidhet miqësisht, çdo mosmarrëveshje, kundërshtim, apo ankim që lind apo lidhet me këtë Statut, apo zgjidhje, mbarim apo pavlefshmëri të saj, do të zgjidhet prej Gjykatës së Rrethit Tiranë.

#### **NENI 16 – DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Mbledhja e parë e themelimit të Shoqatës zgjedh Bordin e parë Drejtues prej 5 anëtarësh, dhe Kryetarin e Shoqatës, të cilët në fillim të vitit pasardhës zëvendësohen me organet përkatëse drejtuese të zgjedhur sipas rregullave të parashikuara në këtë Statut.

Ky statut është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në Shqip.